



REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE

Numri i Ceshtjes : 31155-05138-80-2017 Data e Regjistrimit : 31/08/2017
Numri i Vendimit: 80-2017-4183 Data e Vendimit : 27/10/2017

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:

GJYQTAR: {...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 27/10/2017mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore geshtjen civile qe i perket :

Padites Shoqeria {...} shpk I Paditur DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRONESISE INDUSTRIALE

Objekti:Shfuqizimin e vendimit Nr. 167/8 Protokolli, date 10.07.2017, te Bordit te Apelimit te D.P.P.I. duke vendosur refuzimin e regjistrimit si marke tregtare te Aplikacionit me numer kerkese AL/T/2016/167, date 3 gusht 2016.(Dorezuar me poste per {...} me date 3 Gusht 2017) Marrjen e mases se sigurimit te padise duke vendosur pezullimin e regjistrimin si marke tregtare te aplikacionit me Nr. Kerkese AL/T/2016/167, date 3 gusht 2016, deri ne perfundim te ketij gjykimi

Baza Ligjore:7/a, 10.1, 15/a, 16/1, 17/1.a, (17/1.b), 28, 29/a, 30/a, (35/1), 40 te Ligjit Nr. 49/2012;
Nenet 140.1,2,3; 141.1,2; 142.1,a; 143.1,2,b,3,c,9 ; 152, 153.1, Neni 156, Neni 187, te ligjit Nr. 9947, date 7.7.2008,« Per Pronesine Industriale », ndryshuar me ligjin Nr. 10/2013, date 14.02.2013 dhe ligjin Nr. 55/2014, date 29.05.2014; Vendimi te Keshillit te Ministrave Nr.1706, date 29.12.2008 : "Per miratimin e Rregullores per regjistrimin e Markave Tregtare dhe te Sherbimit", ndryshuar me VKM Nr.550,date 18.06.2015; Nenet 1,3,4 te Ligjit Nr. 9901, date 14.4.2008 "Per tregtaret e shoqerite tregtare (i perditesuar);Nenet 23, 44, 60 te Ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"; Nenet 1,25, 28, 29,30,31 te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.537, date 1.8.2007 " Per Rregullat, per emrat dhe emertimet tregtare"; Nenet 638, 639 te Kodit Civil; Nenet 5, 6 dhe 348 te K. Pr. C .; Nenet 6 bis, 10 bis / 3 te Konventes se Parish "Per Mbrojtjen e Pronesine Industriale", miratuar ne Paris me 20 mars 1883-hyre ne fuqi ne Shqiperi me 4 tetor 1995; Marreveshja e TRIPS-it (Aspekte e Tregtise qe lidhen me Pronesine Intelektuale) - 08.09.2000; Rregullorja (EU) 2015/2424 e Parlamentit Evropian dhe e Keshillit, e dates 16 dhjetor 2015, Paragrafi (13), Neni 9,3.d, Neni 12,1.a.

GJYKATA:

- Ne seancen gjyqesore te dates 27.10.2017 ne zbatim te nenit 34 te ligjit organik mori ne shqyrtim kerkese-padine administrative te pales paditese, sipas objektit si dhe aktet shkresore te depozituara ne gjykim prej paleve ndergjyqese. Degjoi diskutimet perfundimtare te paleve ndergjyqese, ku:

•€€€€€€€€€€€€€€€€€€€€ Pala paditese, perfundimisht kerkoi:

o Pranimin e padise sipas objektit.ligjerimin e mases se sigurimit te padise dhe denimin me gjobe zyres se avokatisë Loloci Associate, ne zbatim te nenit 34 te KPrCivile

•€€€€€€€€€€€€€€€€€€€€ Pala e paditur, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale u gjykua ne mungese por ne diskutimet perfundimtare ka kerkuar rrezimin e padise.

•€€€€€€€€€€€€€€€€€€€€ Avokatura e Shtetit e la gjykimin ne mungese ne seancen per gjykimin e kerkesepadise dhe nuk i ka bere me dije Gjykates qendrimin e saj me shkrim ne lidhje me geshtjen objekt gjykimi.

•€€€€€€€€€€€€€€€€€€€€ Personi i trete, shoqeria tregtare Kantina e Pijeve {...}, sha. kerkoi:

o Rrezimin e kerkese-padise, si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.

si shqyrtoi ne teresi provat e marra gjate gjykimit, ne perputhje me dispozitat materialo-procedurale si dhe referuar ne ligjin organik, me Nr.49/2012 (*lex fori*) "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative" dhe ne bindjen e brendshme, te formuar gjate gjykimit,

VEREN :

Veren:Prane Gjykates se Shkalles se Pare Administrative, Tirane, eshte depozituar ne date 31/08/2017 prej pales paditese padia me objekt dhe shkak ligjor, si me siper. Pjese e objektit te padise ishte dhe kerkesa e pales paditese per marrjen e mases se sigurimit te padise duke vendosur pezullimin e regjistrimin si marke tregtare te aplikacionit me Nr. Kerkese AL/T/2016/167, date 3 gusht 2016, deri ne perfundim te ketij gjykimi. Gjykata me Vendimine ndermjetem nr. S'ka date 13.09.2017 pranoi kerkesen e pales paditese dhe ka urdheruar, si vijon:”Marrjen e mases se sigurimit te padise, pezullimin e gdo procedure administrative te nisur per regjistrimin si marke tregtare te kerkeses se personit te trete te thirrur ne gjykim, shoqeria tregtare “Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}”sha, me me Nr.Kerkese AL/T/2016/167, date 03/08/2017, deri ne perfundim te gjykimit administrativ, me vendim te formes se prere.”

Gjykata me vendim te ndermjetem, ne zbatim te nenit 193 te KPrCivile ka thirrur kryesisht ne gjykim shoqerine qe ka aplikuar per regjistrim te markes, me Nr. Aplikimi AL/T/2016/167, Shoqeria tregtare Kantina e Pijeve {...}, sha., pasi u gmua se terheq interesa ne kete gjykim.

- Faktet dhe rrethana te provuara ne gjykim.

Personi i trete, shoqeria tregtare Kantina e Pijeve {...} ka paraqitur aplikim per regjistrimin e markes {...} me Nr. Aplikimi AL/T/2016/167, lista e mallrave: 21 shishe pijesh, klasa 33 pije alkoolike, prane pales se paditur, Drejtoria e Pergjithshme te Pronesise Industriale, (ne vijim DPPI).

Gjate afatit 3 mujor te publikimit te aplikimit, ne perputhje me parashikimet e ligjit te posagem Nr. 9947, date 7.7.2008, « Per Pronesine Industriale», i ndryshuar rezulton se pala paditese {...} shpk, i ka paraqitur kerkesen (kundershtimin e regjistrimit) me nr. 607 prot date 30.12.2016 pales se paditur, DPPI, per kundershhtimin per regjistrimin si marke tregtare te aplikimit {...} duke pretenduar se, marka per te cilen kerkohet regjistrimi eshte identike me markat tregtare te {...} sh.p.k., te cilat gezojne mbrojtje ligjore, jo vetem ne territorin e Republikes se Shqiperise, per mallra te njejta e te ngjashme si dhe per shkak te ngjashmerise se tyre deri ne perputhje, krijohet mundesia reale e shkakimit te konfuzionit tek publiku dhe e bashkelidhjes me origjinen tregtare dhe me famen e markave te saj.

Rezulton se pala paditese ka te regjistruara prane DPPI 12 marka tregtare, ndersa personi i trete ka te regjistruar ne DPPI 3 marka tregtare “{...}” si dhe ne date 03.06.2016 ka paraqitur per regjistrim prane DPPI aplikimin per marken per mallrat e klasave 21 dhe 33 te Klasifikimit te Nices, aplikimi qe eshte objekt gjykimi.

Kundershtimi i paraqitur nga {...} sh.p.k. eshte shqyrtuar nga Bordi i Apelimit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, i cili me vendimin Nr. 167/8 Prot., date 10.07.2017, dorezuar per {...} sh.p.k. me 3 Gusht 2017, ka vendosur :

«Rrezimin e kundershhtimit te markes me Nr. Aplikimi AL/T/2016/167, aplikuar per regjistrim nga Kantina e Pijeve « Gjergj Kastriot Skernderbeu » sh.a...»

Sa me siper, duke mos qene dakort me vendimmarrjen e pales se paditur DPPI dhe duke pretenduar se vendimi objekt gjykimi eshte marre ne kundershhtim me ligjin material, pala paditese ne date 31.08.2017 ka paraqitur kerkesa-padi ne Gjykate me objektin e siperpermendur.

Sipas provave shkresore te depozitura prej pales paditese rezultoi se, sipas Deshmise se Depozitimit me Nr.12/93, ne date 11/06/1993, ora 12.40 ne Dhomen e Tregtise te RPSSH eshte depozituar kerkesa per regjistrimin e markes tregtare {...} +emblema, ne emer te Kombinantit te te Prodhimit te Pijeve Alkoolike “Ali Kelmendi” Tirane, per mallrat e perfshira ne klasen 33. Bashkelidhur deshimise ne dy faqe eshte pershkrimi narrativ i markes, me elementet dallues dhe pamja vizive e markes. Ne date 06/07/2000, me Nr.122/3 Regjistrimi eshte njoftuar autoritet shteteror ne RSH

per ndryshimin e pronesise se Markes, te regjistruar si me lart, per tek Shoqeria tregtare "{...}" shpk, qe eshte pala paditese.

Personi i trete i thirrur kryesisht prej Gjykates, "Kantina e Pijeve {...}", sha, qe eshte edhe aplikant per regjistrim e markes, eshte mbajtes i se drejtes se emrit tregtar prej vitit 1995. Gjithashtu, personi i trete ka regjistruar ne Shqiperi prej vitit 2003 e ne vijim tri marka me emertim:

"Gjergj Kastrioti {...}" ku elementi figurativ, simboli mesjetar i Kastrioteve, si dhe ai verbal i stilizuar {...}, jane elemente dominante.

Organi administrativ, DPPI qe ka cilesine e pales se paditur ne kete gjykim, nuk ka depozituar asnje prove, te cilat ka patur ne vleresim per vendimmarrjen, qe eshte objekt i gjykimit.

Organi administrativ, DPPI ne rrezimin e kundershimit per regjistrimin e markes, sipas vendimit me Nr. 167/8 Prot., date 10.07.2017, ka argumentuar si vijon: "Ne vijim, Bordit i Apelimit mori ne shqyrtim pretendimet e aplikantit, i cili pretendon ne argumentet dhe pro vat e paraqitura, se ne kuptim te ligjit "Per Pronesine industriale" (i ndryshuar), eshte ai vete mbajtesi i se drejtes se meparshme mbi shenjen ne konflikt. Sa me siper, Bordi i Apelimit konstaton se aplikanti eshte mbajtes i se drejtes se emrit tregtar prej vitit 1995. Gjithashtu aplikanti ka regjistruar ne Shqiperi prej vitit 2003 e ne vijim tri marka me emertim:

"Gjergj Kastrioti {...}" ku elementi figurativ, simboli mesjetar i Kastrioteve, si dhe ai verbal i stilizuar {...}, jane elemente dominante."

Markat e kundershituara si vijon:

1- Me numer regjistrimi kombetar 9722, e mbrojtur prej 02.12.2003 per brandy (pije alkoolike) te klases 33, ne fuqi deri ne 02.12.2023, me pamje:

2- Me numer regjistrimi kombetar 10060, e mbrojtur prej 03.01.2004 per brandy (pije alkoolike) te klases 33, ne fuqi deri ne 3.01.2024, me pamje:

3- Me numer regjistrimi kombetar 16857, e mbrojtur prej 18.02.2016, per brandy (pije alkoolike) te klases 33, ne fuqi deri ne 18.02.2026, me pamje:

Ne driten e ketyre fakteve, si dhe te provave te depozituara nga palet ne kete shqyrtim administrativ, rezulton se te dyja shoqerite jane mbajtese ligjore mbi shenjen ne konflikt, duke e perdorur ate secila ne menyre te pavarur, qetesisht dhe panderprerje, per me shume se 10 vjet. Themi qetesisht dhe panderprerje per shkak se cdonjera prej paleve ka deshmuar vijueshmerine e perdorimit te shenjes nder vite. Po ashtu, nuk eshte depozituar asnje dokument apo prove qe te vertetoje qe gjate periudhes nga aplikimi i markave te sipercituara, te regjistruara nga shoqeria Kantina e Pijeve "Gjergj Kastrioti {...}" Sha, e deri me sot, kundershuesi te kete ushtruar te drejtat e tij te njohura nga nenet 152, 173, 174 dhe 184 e vijues te ligjit 9947, date 07.07.2008 (i ndryshuar). Sa me siper, Bordi i Apelimit konstaton se jemi ne kushtet e percaktuara nga neni 160 i ligjit 9947, date 07.07.2008 (/ ndryshuar)" Vijon argumenti i vendimmarrjes administrative te pales se paditur , se "Vlen te theksohet edhe nje here ne mbeshtetje te kesaj dispozite, se ne dosjen e kundershimit nuk gjendet as ndonje dokument qe provon qe gjate ketyre rreth 13 viteve, d.m.th. prej vitit 2003, kundershuesi te kete depozituar padi ne Gjykate per te kerkuar, shfuqizimin e markave te mevonshme me pretendimin se shoqeria Kantina e pijeve "Gjergj Kastrioti {...}" ka regjistruar markat ne keqbesim. Ne perfundim, Bordi i Apelimit vlereson se, ne kushtet kur jane ezauruar te gjitha mekanizmat ligjore ne favor te mbrojtjes se te drejtes ekskluzive mbi shenjen ne konflikt, nuk mund te pretendohet nga kundershuesi ne kete moment per te drejta te meparshme mbi marken e pretenduar, ne kuptim te nenit 160 te ligjit 9947, date 07.07.2008 (i ndryshuar)

Teresia e fakteve te mesiperme rezulton prej shqyrtimit ne teresi te akteve shkresore te depozituara prej paleve ndergjyqese, brenda afateve ligjore (perpara seances se pare gjyqesore. (Referohu akteve proceduriale te administruara ne dosjen e gjykimit)

Gjykata rendit faktet qe u provuan ne gjykim referuar nenit 35 te ligjit organik, me Nr.49/2012 ku percaktohet barra e proves, duke mbajtur ne konsiderate kerkimet e pales paditese dhe lidhjen e drejtperdrejte te fakteve me pretendimet.

- Pretendimet e pales paditese

Pala paditese kerkoi nga gjykata pranimin e kerkesepadise sipas objektit te saj duke shfuqizuar Vendimin nr. 167/8 Prot date 10.07.2017 te Bordit te Apelimit te D.P.P.I duke vendosur refuzimin e regjistrimit si marke tregtare te Aplikacionit me numer kerkese AL/T/2016/167, date 3 gusht 2016.

Pala paditese pretendon se, aplikimi per marke i personit te trete eshte identik me markat tregtare te shoqerise "{...}" shpk te cilat prej dhjetera vitesh gezojne mbrojtje ligjore, jo vetem ne territorin e Republikes se Shqiperise, per mallra te njejta dhe te ngjashme si dhe per shkak te ngjashmerise se tyre deri ne perputhje, krijohet mundesia reale e shkaktimit te dhe e bashkelidhjes me origjinen tregtare dhe me famen e markave te saj.

Pala padites pretendon se, gjate procedimit administrativ ka paraqitur Bordit te Apelimit provat e nevojshme, dokumente shkresore, me vlere te plote provuese, me te cilat jane plotesuar njekohesisht kushtet e kerkuara nga neni 143, pika 2 e ligjit 9947, date 7.7.2008 (i ndryshuar) me qellim, qe te provohet se « kemi te bejme me shkelje te te drejtave te meparshme » dhe Bordi pasi ka analizuar e diskutuar te gjitha keto prova, ne menyre te shprehur ka arritur ne kete perfundim:« Bordi i Apelimit i D. P. P. M. gjate analizes se ngjashmerise konstaton se markat ne shqyrtim paraqesin ngjashmeri te larte ne aspektin vizual, fonetik dhe ate konceptual per shkak se marka e kundershuar permban te njejtat elemente figurative dhe verbale, te cilat gjenden gjithashtu si elemente dominante ne markat kundershuese ». « Gjithashtu marka e kundershuar kerkon te mbrohet per te njejtat mallra te klases 33 te klasifikimit te Nices, per te cilat jane te mbrojtura tashme markat kundershuese ».

Pala padites pretendon se, BA ka perdorur gabimisht ligjin material dhe vendimi i bazuar ne kete perdorim eshte rrjedhimisht i gabuar. Bordi i Apelimit e ka perdorur ne menyre false dhe spekulative proceduren dhe ligjin per marrjen e ketij vendimi. BA nuk prononcohet per ngjashmerine e pakundershueshme mes markave dhe mallrave, dhe nuk merret qellimisht me pasojen qe eshte konfuzioni mbi mallrat/origjinen e mallrave ne rast bashke-ekzistence te markave identike, por e hedh poshte kundershtimin bazuar ne nenin 160 te ligjit nr. 9947/2008 ne nje kohe kur neni 160 nuk eshte pjese e neneve qe i referohen procedures ligjore te kundershimit te markes dhe rregullave te opozites per rregjistrimin e markes se publikut, pikerisht per kundershtim.

Pala paditese pretendon se, Bordi i Apelimit, ne rastin konkret, duke u treguar haptazi i njeanshem, ka dale pertej objektit te kerkeses dhe ka vendosur per geshtje qe nuk kane qene dhe nuk jane objekt i kerkeses tone te kundershimit. Kujtojme se, objekti i kerkeses tone te kundershimit ka qene dhe eshte «kundershimi i regjistrimit si marke tregtare i aplikacionit {...}, Nr. AL/T/2016/167 date 03.08.2016 » dhe aspak « deklarimi i pavlefshem i markave tregtare te regjistruara nga aplikanti ne datat 02.12.2003 ; 03.01.2004 dhe 18.02.2016 ». Kushti i dyte i kerkuar nga neni 160 i ligjit nuk eshte plotesuar, sepse nuk kemi nje « pranim ne heshtje per nje periudhe te panderprere pese vjegare per perdorimin e markes te regjistruar me vone... », pasi nga data e depozitimit te kerkeses, 3 Gusht 2016, deri ne momentin e kundershimit, 30 Dhjetor 2016, nuk jane plotesuar ende 4 muaj. Bordi i Apelimit, ne rastin konkret, duke u treguar haptazi i njeanshem, ka dale pertej objektit te kerkeses dhe ka vendosur per geshtje qe nuk kane qene dhe nuk jane objekt i kerkeses tone te kundershimit. Kujtojme se, objekti i kerkeses tone te kundershimit ka qene dhe eshte «kundershimi i resiistrimit si marke trestare i aplikacionit {...}, Nr. AL/T/2016/167 date 03.08.2016 » dhe aspak « deklarimi i pavlefshem i markave tregtare te regjistruara nga aplikanti ne datat 02.12.2003 ; 03.01.2004 dhe 18.02.2016

»Pergjigja eshte plotesisht e qarte: eshte aplikacioni {...}, me numer kerkese AL/T/2016/167 date 03.10.2016, i cili ka qene objekt kundershimi prej nesh dhe objekt shqyrtimi nga Bordi i Apelimit ne vendimin Nr.167/8, date 10.07.2017 dhe jo markat e tjera te regjistruara me pare ne vitet 2003, 2004 e shkurt 2016, te cilave ne menyre spekulative i referohet Bordi ne vendimin e tij. Gjithashtu, pala paditese pretendon se, ne vendimin Nr. 168/8 Prot, date 10.07.2017, Bordi i Apelimit ka pranuar «heshtjen » e kundershuesit, mbajtesit te te drejtave te mbrojtura te markes, pa iu referuar asnjeres prej provave te paraqitura prej nesh per kete geshtje.

Duke u mbeshtetur ne sa siper por jo vetem aq, provohet se heshtja nuk ka ekzistuar asnjehere, si shfaqje e vullnetit te paditesit (te {...} sh.p.k.), sepse ai here pas here ka ngritur padi pas padish ne organet gjyqesore dhe apelime ne borde administrative, brenda e jashte vendit, gje qe provon per perpjekje te vazhdueshme te paditesit, per te penguar shkeljen e te drejtave te tij, te cilat buronin nga marka tregtare ne pronesi te tij. Kur nje biznes perdor emrin e saj tregtar per te identifikuar produktet ose sherbimet e tij, atehere emri funksionon si marke tregtare dhe duhet te merret parasysht ligji per marken tregtare. Nje kompani ka te drejten ligjore te perdore nje emer si marke tregtare vetem ne ate mase qe nuk cenon markat tregtare ekzistuese. Nese emri tregtar eshte i ngjashem me marken tregtare te nje tjetri, se krijon nje "gjase konfuzioni" ne mendjen e nje bleresi, ai mund te cenoje marken tregtare, e cila mund te jete nje gabim shume i kushtueshem.

Per te gjykuar mbi mundesine e konfuzionit, e thene ndryshe mbi rrezikun e ngaterrimit te markave, duhet te merren ne konsiderate ngjashmeria e mallrave dhe sherbimeve, fuqia identifikuese e markes me te vjeter si dhe ngjashmeria e markave te perballura, ku keta faktore jane ne bashkeveprim me njeri- tjetrin, keshtu qe shkalla e ulet e nje faktori mund te kompensohet nga nje shkalle me e larte e nje faktori tjetere. Paditesi ka arsyetuar ne menyre te detajuar ngjashmerine e markave ne pronesi te tij dhe markes per te cilen eshte paraqitur aplikimi nga personi i trete ne keto drejtime; ne ngjashmerine e mallrave dhe sherbimeve, si dhe ngjashmerine e markave ne aspektin zanor, vizual dhe konceptual. Provohet ne menyre te padiskutueshme se pronar i markes tregtare "{...}" me numer kombetar regjistrimi (AL) ka qene vetem shoqeria {...} shpk, si trashegimtar i ligjshem i kesaj marke ne pronesi te Kombinatit te Prodhimit te Pijeve Alkolike "Ali Kelmendi", per kete fakt ne paraqitur prova shkresore, ndersa prej shoqerise tjeter ne kete gjykim nuk u paraqiten prova mbi kete fakt edhe pse u la si detyre prej gjykates ne seance pergatitore.

• Prapesimet e pales se paditur

Pala e paditur, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale u gjykua ne mungese. Per sa i perket pretendimeve te themelit te padise nuk depozitoi prapesime me shkrim si akte shkresore, ne zbatim te nenit 35, 37 (barra e proves ne gjykimin administrativ) dhe 25 germa (b) te ligjit te posagem organik me Nr.49/2012 i ndryshuar.

Ne seancen gjyqesore per t'u degjuar diskutimet perfundimtare, u paraqit perfaqesuesja e autorizuar e organit administrativ dhe depozitoi qendrimin e saj me shkrim per themelin e padise.

Pala e paditur prapesoi per rrezimin e padise administrative, duke argumentuar si me poshte vijon : Neni 143 pika 2 germa "b" e Ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 parashikon se cilat kushte ligjore duhet te plotesohen me qellim qe te kemi te bejme me shkelje te te drejtave te meparshme, Keto kushte jane: marka qe kundershohet eshte e njejte ose e ngjashme me marken e meparshme; marka qe kundershohet kerkon mbrojtje per te njejtat mallra ose sherbime, ose per mallra apo sherbime te ngjashme me ato per te cilat eshte mbrojtur marka e meparshme; c) ngjashmeria mes markes qe kundershohet dhe markes se meparshme dhe e mallrave per te cilat mbrohen ato eshte e tille qe shkakton konfuzion tek konsumatori ose sjell si pasoje bashkelidhjen mes markave.

Ne interpretim te kesaj dispozite, ngjashmeria e markes se mevonshme me marken e meparshme dhe

ngjashmeria e mallrave apo sherbimeve per te cilat mbrohen markat, perben shkak per refuzimin e regjistrimit te markes se mevonshme veteni nese per shkak te kesaj ngjashmerie, ekziston mundesia e shkaktimit te konfuzionit te publiku, perfshire edhe mundesine e bashkelidhjes mes markave. Per kete arsye, ngjashmeria mes markave dhe mes mallrave per te cilat mbrohen ato, duhet te vleresohet e lidhur ngushte me mundesine e shkaktimit te konfuzionit ose bashkelidhjes mes markave.

Ne lidhje me ceshtjen e te dyjave markave personi i trete paraqiti prane DPPI kerkesen per kundershimin e markes me numer aplikimi kombetar AL/T/2016/167, i depozituar per regjistrim nga shoqeria "Kantina e pijeve "Gjergj Kastrioti {...}" Sha", me date 03/06/2016, Aplikanti ka kerkuar mbrojtjen e markes per mallrat e klasave 21 dhe 33 te Klasifikimit te Nices, konkretisht per:

10- shishe pijesh.

44- pije alkoolike.

Marka e kundershuar eshte publikuar me 03.10.2016 ne buletin e markave Nr. 2016/10 te DPPI.

Kunder kesaj marke eshte depozituar, me date 30.12.2016, kerkesa per kundershimin e regjistrimit te saj nga subjekti {...} Shpk, ne perputhje me parashikimet e nenit 152 pika 1/a e Ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008. Paditesi me ane te argumenteve dhe provave te depozituara ne dosjen e aplikimit per kundershim, pretendon se eshte pronar i markave te siperpermendura dhe gezon te drejta te meparshme kundrejt aplikimit kombetar te kundershuar AL/T/2016/167. Si pasoje marka e kundershuar cenon rende te drejtat e markes se tij. Personi i trete qe kundershohet iu pergjigj ketij kundershimi brenda afateve ligjore, nepermjet dokumenteve prapesuese dhe provave te depozituara. Personi i trete ka pretenduar nga ana e tij se te drejtat e meparshme ne te gjitha markat e serise "Gjergj Kastrioti {...}" i takojne ne te vertete aplikantit, si perdoruesi i pare i kesaj marke ne treg, si dhe si mbajtes me i hershem i se drejtes se emrit tregtar "Gjergj Kastrioti {...}".

Ne vijim, Bordi i Apelimit i DPPI, bazuar ne dispozitat e mesiperme ligjore, e perqendroi diskutimin ne tre geshtje kryesore: Bordi i Apelimit te DPPI, analizoi ngjashmerine ndermjet markave ne konflikt:

Njeanshmeria ndermjet markave.

Per te bere nje analize te sakte te ngjashmerise ndermjet dy markave, duhet te merret ne konsiderate teresia e elementeve perberese te tyre dhe pershtypja e pergjithshme qe shkaktojne ato tek konsumatori, por duke u fokusuar me teper ne elementet qe luajne rolin kryesor ne krijimin e karakterit dallues te markave.

Bordi i Apelimit i DPPI gjate analizes se ngjashmerise konstatoi se markat ne shqyrtim paraqesin ngjashmeri te larte ne aspektin vizual, fonetik dhe ate konceptual per shkak se marka e kundershuar permban te njejtat elemente figurative dhe verbale te cilat gjenden gjithashtu si elemente dominante ne markat kundershuese.

Gjithashtu marka e kundershuar kerkon te mbrohet per te njejtat mallra te klases 33te klasifikimit te Nices, per te cilat jane te mbrojtura tashme markat kundershuese.

Ne vijim, Bordit i Apelimit mori ne shqyrim pretendimet e aplikantit, i cili pretendoi ne argumentet dhe provat e paraqitura, se ne kuptim te ligjit "Per Pronesine industriale" (i ndryshuar), eshte ai vete mbajtesi i se drejtes se meparshme mbi shenjen ne konflikt.

Sa me siper, Bordi i Apelimit konstatoi se aplikanti eshte mbajtes i se drejtes se emrit tregtar prej vitit 1995. Gjithashtu aplikanti ka regjistruar ne Shqiperi prej vitit 2003 e ne vijim tri marka me emertim: "Gjergj Kastrioti {...}" ku elementi figurativ, simboli mesjetar i Kastrioteve, si dhe ai verbal i stilizuar {...}, jane elemente dominante. Ne driten e ketyre fakteve, si dhe te provave te depozituara nga palet ne shqyrtimin administrativ, rezultoi se te dyja shoqerite jane mbajtese te te drejtave ligjore mbi shenjen ne konflikt, duke e perdorur ate secila ne menyre te pavarur, qetesisht dhe panderprerje, per me shume se 10 vjet. Themi qetesisht dhe panderprerje per shkak se ndonjera prej

paleve ka deshmuar vijueshmerine e perdorimit te shenjes nder vite. Po ashtu, nuk eshte depozituar asnje dokument apo prove qe te vertetoje qe gjate periudhes nga aplikimi i markave te sipercituara, te regjistruara nga shoqeria Kantina e Pijeve "Gjergj Kastrioti {...}" Sha, e deri me sot, kundertshtuesi te kete ushtruar te drejtat e tij te njohura nga nenet 152, 173, 174 dhe 184 e vijues te ligjit 9947, date 07.07.2008 (/ ndryshuar). Sa me siper, Bordi i Apelimit konstatoi se jemi ne kushtet e percaktuara nga neni 160 i ligjit 9947, date 07.07.2008 (/ ndryshuar) ku thuhet: "1. Kur pronari i nje marke te meparshme, ne perputhje me percaktimin e pikes 5 te nenit 143 te ketij ligji, pranon ne heshtje, per nje periudhe te panderprere pesevjeqare perdorimin e nje marke te regjistruar me vone ne Republiken e Shqiperise, ai nuk ka me te drejte, sipas se drejtes qe rrjedh nga regjistrimi i markes se meparshme, te kerkoje deklarimin e pavlefshem te markes se mevonshme ose ta kundertshtojte perdorimin e markes se mevonshme per mallrat ose sherbimet, per te cilat marka e mevonshme eshte perdorur, perveq kur regjistrimi i markes se mevonshme eshte aplikuar ne keqbesim. "

Vlen te theksohet edhe nje here ne mbeshtetje te kesaj dispozite, se ne dosjen e kundertshtimit nuk gjendet as ndonje dokument qe pro von qe gjate ketyre rreth 13 viteve, d.m.th. prej vitit 2003, kundertshtuesi te kete depozituar padi ne Gjykate per te kerkuar, shfuqizimin e markave te mevonshme me pretendimin se shoqeria Kantina e pijeve "Gjergj Kastrioti {...}" ka regjistruar markat ne keqbesim. Bordi i Apelimit vleresoi se, ne kushtet kur jane ezauruar te gjitha mekanizmat ligjore ne favor te mbrojtjes se te drejtes ekskluzive mbi shenjen ne konflikt, nuk mund te pretendohet nga kundertshtuesi ne kete moment per te drejta te meparshme mbi marken e pretenduar, ne kuptim te nenit 160 te ligjit 9947, date 07.07.2008 (/ ndryshuar).

Si perfundim, pala e paditur prapeson se, :

-Bordi i Apelimit mori ne shqyrtim ne teresi gjendjen faktike dhe ligjore te markave te regjistruara te shoqerive "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}" dhe "{...}" sh.p.k., te cilat jane te regjistruara per me shume se 10 vjetesh, regjistrime dhe fakte te cilat Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Indsutriale (DPPI) eshte e detyruar t'i njohet dhe nuk mund t'i ndryshoje. Sipas ligjit 9947, kundertshtimi, shfuqizimi ose revokimi i markave tregtare behet nga personat e trete te interesuar brenda afatave ligjore te percaktuara, gje e cila nuk eshte bere me pare ne asnje rast ne DPPI apo prane organeve gjyqesore kompetente.

-Ne keto kushte, asnjera prej shoqerive, Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...} dhe {...} shpk, si pronare te markave tregtare, nuk mund te zoteroje ekskluzivitetin mbi markat "Gjergj Kastrioti {...}" te regjistruara, pasi te dyja shoqerite kane te drejta te meparshme qe rrjedhin nga zoterimi i markave tregtare te tyre.

-Nisur nga rrethanat faktike dhe ligjore, ashtu si edhe bazuar ne provat e dokumentat e paraqitura nga palet, Bordi i Apelimit e rrezoi kundertshtimin per regjistrimin e markes {...} (AL-T-2016-167) pasi sipas Bordit ky aplikim eshte vazhdim i markave te aplikantit ("Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}"), te cilat sic u tha, jane rregullisht te regjistruara prane DPPI-se, ashtu si9 jane edhe ato te kundertshtuesit ("{...}"). Secili prej tyre, aplikanti dhe kundertshtuesi, kane pranuar ekzistencen e markave tregtare te njeri-tjetrit sipas nenit 160 te ligjit 9947. Rrjedhimisht, Bordi i Apelimit nuk mund te mos pranonte bashke-ekzistencen dhe mosregjistrimin e nje marke te njejte me ato te meparshme. Ne rast se Bordi i Apelimit do te refuzonte aplikimin e aplikuesit, do te mbante nje qendrim te njehshem ndaj regjistrimeve te meparshme te njeres ose tjetres shoqeri.

Per keto argumenta e pala e paditur kerkoi rrezimin e Kerkese - Padise , lenien ne fuqi Vendimin e Bordit te Apelimit dhe vazhdimin e procedures se regjistrimit per marken me numer AL/T/2016/167 aplikimi, me aplikant shoqeria "Kantina e pijeve "Gjergj Kastrioti {...}" Sha", dhe pranimin e regjistrimit te sai.

• Qendrimi dhe prapesimet e personit te trete, shoqeria tregtare, "Kantina e Pijeve {...} sha
Personi i trete, thirrur kryesisht prej Gjykates, shoqeria tregtare Kantina e Pijeve {...} sha u shpreh se ne gjykim bashkohet me palen e paditur dhe kerkon rrezimin e kerkesepadise si te pambeshtetur ne ligj dhe ne prova. Personi i trete, shoqeria "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}" sh.a. (ne vijim "Personi i Trete") eshte nje shoqeri tregtare ne Republikën e Shqiperise dhe ne rajon ne fushen e prodhimit, tregtimit, shperndarjes dhe shitjes se produkteve te pijeve alkoolike.

Personi i trete pretendoi ne gjykim, se, nepermjet perdorimit ne menyre te panderprere te markes GJERGJ KASTRIOTI {...} per nje periudhe kohe tejet te gjate per produktet pije alkoolike, kjo marke, ne kuptim te nenit 141 te Ligjit nr. 9947 date.07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" (i ndryshuar) (ne vijim "Ligji 9947"), ka fituar nje karakter dallues teper te larte ne treg duke bere te mundur dallimin e mallrave te saj (produkte alkoolike) nga mallrat e tjere te njejte apo te ngjashem qe i perkasin shoqerive te tjera.

Personi i trete prapeson se si pasoje e perdorimit dhe tregtimit te saj te gjere prej disa dekadash, marka e "Kantines Gjergj Kastrioti {...}" eshte mjaft e njohur nga konsumatorët ose publiku perkates ne shkalle kombetare dhe nderkombetare-rajonale, ne nje nivel te tille saqe ka fituar statusin e markes se mirenjohur ne kuptim te nenit 6bis te Konventes se Parisit "Per mbrojtjen e Pronesise Industriale", akt qe eshte ratifikuar edhe nga shteti shqiptar.

Kantina Gjergj Kastrioti {...} ka regjistruar tre marka trgtare si dhe nje disenjo industriale. Se fundi, Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...} gezon edhe te drejten e emrit tregtar qe nga data e themelimit te saj, date 02.08.1995 Pra, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe veganerisht me nenin 143(3)(a) te Ligjit 9947, personi i trete perfiton dhe gezon para se gjithash edhe te drejten e emrit tregtar si nje e drejte e meparshme, pasi marka ne pronesi te paditesit me numer regjistrimi AL 45 ka qene ne pronesi te Dhomes se Tregtise Tirane dhe vetem ne vitin 2000 (shoqeria "{...}" sh.p.k. eshte themeluar ne vitin 14/12/1999) pronesia e kesaj marke ka kaluar ne favor te paditesit. Po keshtu, marka "Gjergj Kastrioti {...} brandy" me numer regjistrimi AL 10313 ka kaluar ne pronesi te shoqerise "{...}" sh.pk. vetem ne vitin 2005, shume me vone se sa data ne te cilen personi i trete ka fituar te drejten e emrit tregtar Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}.

Ne vijim te regjistrimeve te markave tregtare te tij te meparshme dhe me qellim (i) qe te siguroje nje mbrojtje sa me te plote te ketyre markave nga veprimtari te kunderligjshme te paditesit apo personave te tjere, si dhe (ii) per te rritur nivelin e dallueshmerise se markave te tij te regjistruara, Kantina Gjergj Kastrioti {...} ka aplikuar per regjistrimin e markes {...} (AL/T/2016/167) ne date 03.08.2017 duke perfshire elementin literal "DURRES" si pjese perberese te markes ne menyre qe te beje te mundur nje daliim sa me te larte te produkteve te tij nga ato te Paditesit. Aplikimi per regjistrim te markes tregtare eshte depozituar ne menyre te rregullt dhe ne perputhje te plote me ligjin 9947.

Se pari, veme ne dukje se Kantina Gjergj Kastrioti {...} nuk ka cenuar apo shkelur asnje dispozite ligjore te referuar nga paditesi, aq me pak te kete shkelur ndonje te drejte te pronesise industriale te ketij. Per kete arsye, aplikimi per regjistrimin e markes {...} (fjale &figure) (AL/T/2016/167) nuk eshte gje tjeter, vegse vazhdim i serise se markave tregtare te regjistruara me pare po nga personi i trete dhe sig u tha me siper, me qellim qe te dalloje me qarte mallrat e tij nga ato te paditesit.

Nenet 140 (1)(2)(3), 141 (1)(2), 142 (l)(a), dhe 156 te Ligjit 9947 qe paditesi referon si baze ligjore ne te cilen mbeshtetet kerkese-padia, jane te pasakta dhe te pakuptimta pasi nuk kane asnje lidhje me objektin e kerkese-padise.

Konkretisht, nenet 140 dhe 141 te Ligjit 9947 kane te bejne respektivisht me shenjat qe perbejne nje marke dhe karakterin dallues te markes tregtare. Edhe me absurd dhe i pakuptimte eshte mbeshtetja e kerkese-padise ne nenin 142 te ligjit 9947, pasi ky nen lidhet ekskluzivisht me refuzimin e regjistrimit te markes tregtare per shkaqe absolute nga ana e DPPI-se gjate procedures se ekzaminimit te aplikimit. Kjo faze eshte ezauruar plotesisht nga DPPI-ja dhe ka perfunduar me publikimin e markes, e cila eshte edhe kundershuar, sig u tha edhe me lart.

Perveç sa me siper, ekzaminimi i markes bazuar mbi shkaqet absolute eshte nje kompetence ekskluzive e DPPI-se qe nuk mund te kundershohet prane organeve gjyqesore nga pale te treta. Po ashtu, neni 156 lidhet drejtperdrejt me te drejtat qe gezon pronari i nje marke tregtare te regjistruar ne rastin e shkeljeve te te drejtave te pronesisë industriale nga cdo person qe perdor ne menyre te paautorizuar nje shenje te ngjashme/identike me marken e regjistruar te tij.

Theksojme ketu se Kantina Gjergj Kastrioti {...} gezon prej shume vitesh te drejtat e pronesisë industriale qe rrjedhin nga regjistrimi i disenjos industriale apo markave tregtare te saj nen emertimin "Gjergj Kastrioti {...}", ashtu si edhe te drejten e emrit tregtar.

Procedura e kundershimit te nje aplikimi per regjistrim marke dhe e vendimarrjes se Bordit te Apelimit parashikohet ne menyre te hollesishme nga nenet 152, 153 te Ligjit 9947 dhe nga Rregullorja e Markave. Nga leximi, interpretimi dhe analizimi i dispozitave ligjore perkatese rezulton qarte se Bordi i Apelimit shqyrton pike se pari nese kundershimi eshte ne perputhje me kerkesat e Ligjit 9947 dhe njofton palet per vendimin e marre vetem pasi shqyrton kundershimin dhe dokumentat/provat e paraqitura nga palet gjate procedures se kundershimit.

Pike se pari, ne lidhje me pretendimet e Paditesit, veme edhe nje here ne dukje se Kantina Gjergj Kastrioti {...} gezon te drejten e emrit tregtar duke filluar qe nga momenti i regjistrimit te saj me date 02.08.1995 me objekt aktiviteti si vijon: Prodhim, tregtim, pije alkoolike, vere, pije joalkoolike, import, eksport te prodhimeve te veta dhe atyre qe mund te sigurohen nga bartesi, import, eksport lendesh te para e ndihmese dhe nenprodukteve qe rrjedhin nga perpunimi industrial i tyre, etj.. Regjistrimi i emrit tregtar te personit te trete ("Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}") nuk eshte kundershuar as nga shteti, dhe as nga ndonje person tjeter ne perputhje me legjislacionin e kohes brenda afatit ligjor.

Gjithashtu, personi i trete ka prodhuar, tregtuar, shperndare dhe ofruar per shitje produkte alkoolike brandy/konjak me emertimin dhe logon "{...}" qe nga viti 1967. Nje fakt i tille eshte provuar rregullisht dhe ne perputhje me ligjin prane Bordit te Apelimit te DPPI-se, me anen e faturave te shitjeve dhe deklaratat doganore te produkteve alkoolike te markave "Gjergj Kastrioti {...}".

Paditesi, shoqeria "{...}" sh.p.k., eshte themeluar si shoqeri tregtare me daten 14.12.1999 dhe ka fituar te drejtat qe rrjedhin nga marka tregtare "GJERGJ KASTRIOTI {...}" vetem ne vitin 2000, kur pronesia e markes tregtare "Gjergj Kastrioti {...}" me numer regjistrimi AL 45 ka kaluar nga prone shteterore ne favor te paditesit. Theksojme ketu, qe gjate gjithë kesai periudhe kohore, marka "Gjergj Kastrioti {...}" zoterohej nga shteti, i cili ka qene personi i vetem qe gezonte te drejten mbi kete marke tregtare.

Ne analogji me marken me numer regjistrimi AL 45, edhe marka tjeter "Gjergj Kastrioti {...} brandy" me numer regjistrimi AL 10313 ka kaluar ne pronesi te paditesit vetem ne vitin 2005. Ne keto kushte, shteti si pronar i markes tregtare ne fjale, i lejonte dhe i njihte te dy shoqerite, "Kantinen e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}-Dures" dhe "Kombinatin Ushqimor Ali Kelmendi-Tirane, qe te prodhonin e tregtonin produkte alkoolike te ilojit konjak/brandy nen emertimin dhe logon "Gjergj Kastrioti {...}".

Ne keto rrethana, eshte lehtesisht e kuptueshme qe asnjera nga shoqerite tregtare, "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}-Durres" apo shoqeria "{...}" , nuk mund te pretendoje ekskluzivitetin e perdorimit te markes "Gjergj Kastrioti {...}" per produktet alkoolike te llojit brandy/konjak. Ky konkluzion perforcohet edhe me tej ne rast se mbajme parasysh faktin qe te dy keto shoqeri, kane aktualisht te regjistruara prane DPPI-se nje seri markash tregtare te njejta me logon "Gjergj Kastrioti {...}".

Sic rezulton edhe nga vendimi i Bordit te Apelimit, markat tregtare "Gjergj Kastrioti {...}" jane te regjistruara ne emer te dy shoqerive ne fjale per nje periudhe tejet te gjate kohe (me shume se 10 vjet), dhe ato nuk kane qene asnjehere objekt kundershimesh apo kontestimesh administrative apo gjyqesore deri me sot.

Ne keto kushte, marka e re {...} eshte thjesht vazhdim i markave te meparshme te personit te trete, te cilat jane ne fuqi dhe nuk jane kundershtuar ndonjehere me pare nga paditesi apo persona te tjere. Prandaj, edhe kundershtimi i markes me numer aplikimi AL/T/2016/167 i personit te trete nuk ka baze. Per me teper, me ane te ketij aplikimi te ri, personi i trete i ka shtuar markes "{...}" (element qe karakterizon te gjithë markat tregtare te meparshme te personit te trete), edhe elementin literal-fjale "DURRES" duke rritur ne menyre dallimin midis origjines tregtare te mallrave te personit te trete dhe atyre te paditesit. Shkurt, marka e re {...} (AL-T-2016-167) eshte aplikuar per regjistrim nga personi i trete ne baze te te drejtes se tij te meparshme te emrit tregtar, si dhe te regjistrimeve te meparshme qe ai zoteron (AL 9722, AL 10060, AL 16857 dhe I 239). Si rrjedhoje, paditesi apo gdo person tjetër nuk mund te kundershtojë regjistrimin e markes {...} (AL-T-2016-167) duke pretenduar qe ai gezon te drejta ekskluzive te meparshme, pasi te drejta te tilla te meparshme, para se gjithash, i ka vete personi i trete.

Si perfundim, pretendimi i paditesit se vendimi i Bordit te Apelimit nuk eshte fokusuar ne objektin e kundershimit-ngjashmeria midis markave dhe nuk duhet te referohej ne nenin 160 te Ligjit 9947, eshte teresisht i pakuptimte dhe i pambeshtetur ne ligj. Eshte teresisht e kunderligjshme, absurde dhe jo-logjike te pretendosh qe Bordi i Apelimit nuk mund e nuk duhet t'i referohet ekzistences ne treg te markave tregtare te njejta, aq me teper ne rrethana faktike te tilla kur kohezgjatja ne treg e markave dhe produkteve "Gjergj Kastrioti {...} brandy" te dy shoqerive perkatese eshte mese evidente. Kete fakt, as Bordi i Apelimit, as gjykata nuk mund ta mohojë, pasi kjo bashke-ekzistence eshte konfirmuar permes dispozitave ligjore. Ne keto kushte, paditesi dhe personi i trete nuk mund te bejne gje tjetër vegse te rrisin elementet e dallueshmerise se markave te tyre te njejta, me qellim qe konsumatori mesatar te jete ne gjendje te dalloje produktet e personit te trete nga ato te paditesit. Ne kete kuptim, personi i trete po ben pikerisht kete.

Gjithashtu, nuk eshte e vertete qe Bordi i Apelimit nuk eshte fokusuar ne ekzistencen e ngjashmerise ndermjet markave (shih faqen 6 te Vendimit te Bordit te Apelimit nr. 167/8, date 10.07.2017), por pas shqyrtimit te provave e dokumentave te depozituara nga palet gjate shqyrtimit administrativ, vete Bordi i Apelimit ka konstatuar se "aplikanti eshte mbaites i se drejtes se emrit tregtar prej vitit 1995. Gjithashtu, aplikanti ka reaiistruar ne Shaiperi prej vitit 2003 e ne vijim tri marka me emertimin: "Gierai Kastrioti {...} ku e/ementi fiaurativ. simbo/i mesietar i Kastrioteve. si dhe ai verba! i stilizuar "{...}". iane etemente dominante."

Se fundi, argumentimet e ndryshme te Zyrrave te Pronesise Intelektuale ne raste te peraferta (theksojme se ne te gjitha keto raste nuk ndodhemi perpara rrethanave te njejta me rastin ne gjykim) qe jane paraqitur nga paditesi si prove ne mbeshtetje tepretendimeve te tij, nuk kane lidhje me ceshtjen ne gjykim, as nuk provojne gje, si dhe jane jashte objektit gjyqesor te ceshtjes. Pretendimi qe Bordi i

Apelimit ka pranuar apriori pretendimin e personit te trete mbi ekzistencen e te drejtes se emrit tregtar eshte teresisht i pasakte dhe i pavertete, pasi personi i trete ka paraqitur ne menyre te rregullt dhe ne perputhje me ligjin ekstraktin e regjistrimit tregtar me te dhenat e personit te trete - subjekti "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}", te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit, si prove ne mbeshtetje te pretendimeve te tij.

Marka "GJERGJ KASTRIOTI {...}" ose shkurtimisht e njohur edhe si "{...}" e Kantines Gjergj Kastrioti {...}, ka fituar nje karakter dallues teper te larte gjate perdorimit te saj ne lidhje me produktet alkoolike.

Produktet alkoolike me emrin dhe logon "{...}" jane shitur e tregtuar ne menyre te panderprere nga personi i trete prej shume dekadash duke filluar nga vitet 70'(d.m.th. shume kohe perpara dates se themelimit te shoqerise "{...}"shpk) deri ne ditet e sotme.Pra, pronari me i hershem qe ka tregtuar marken tregtare me emrin dhe logon "GJERGJ KASTRIOTI {...}" per pije alkoolike, per me shume se 5 dekadash, eshte Kantina Gjergj Kastrioti {...}, cka provohet edhe me faturat e shitjeve qe i jane paraqitur rregullisht Bordit te Apelimit te DPPI-se.

Gjithashtu, vec faktit qe marka e kundershuar {...} me numer kombetar aplikimi AL/T/2016/167 eshte kerkuar te regjistrohet edhe per mallrat "shishe pijesh" qe i perkasin klases 21 te Klasifikimit te Nices (jo vetem per mallrat produkte alokolike qe perfshihen ne klasen 33), kjo marke nuk eshte e ngjashme nga pikepamja konceptuale me markat e paditesit. Sic u tha edhe me siper, personi i trete duke i shtuar elementin literal "Durres" e ben edhe me te dallueshme kete marke te re nga markat e paditesit Keshtu, me te drejte Bordi i Apelimit, edhe ne mbeshtetje te nenit 160 te ligjit 9947, thekson se shenja Gjergj Kastrioti {...} eshte perdorur ne menyre te pavarur, te qete dhe te panderprere per produktet alkoolike brandy (klasa 33 e Klasifikimit te Nices) per nje periudhe me shume se 10- vjecare. Ne kete kuptim, pavaresisht faktit nese kemi te bejme me nje aplikim te ri, paditesi nuk mund te kundershtojte regjistrimin e markes se personit te trete per te gjitha arsyet e siperpermendura. Si rrjedhoje, edhe cdo argument apo pretendim rreth krijimit te konfuzionit midis markave te paditesit dhe personit te trete eshte i pavend dhe nuk qendron.

Pretendimi i Paditesit se Bordi i Apelimit nuk i eshte referuar ndonje dokumenti qe provon te drejtat e emrit tregtar te personit te trete eshte teresisht i pavertete dhe i pasakte. Sig mund te konstatohet lehtesisht nga dosja e markes ne fjale, personi i trete ka paraqitur se bashku me prapesimet e tij edhe: Ekstraktin e regjistrimit tregtar me te dhenat e subjektit "Kantina e Pijeve Gjergj Kastrioti {...}" te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit; dhe Faturat e shitjeve dhe deklaratat doganore te produkteve alkoolike te markave "Gjergj Kastrioti {...}, ku provohet karakteri dallues i forte i markes se personit te trete.

Pretendimet e paditesit per shkelje te te drejtave te pronesis se industriale jane jo vetem te pasakta e te paverteta, por ato nuk lidhen ne asnje moment me proceduren e kundershimit te regjistrimit te nje marke te publikuar. Per pasoje, keto pretendime jane teresisht jashte objektit gjyqesore percaktuar. Po ashtu, pretendimi i paditesit se aplikimi per regjistrim marke AL/T/2016/167 duhet refuzuar sepse eshte ne kundershitim me praktikat e vendeve te tjera te botes, eshte absurd dhe i pakuptimte. Nocioni i markes tregtare lidhet drejtpersedrejt me territorin ne te cilin marka qe kerkon te regjistrohet do te perdoret. Ne te njejten linje arsyetimi, pretendimet e Paditesit rreth ekzistences se aplikimeve/regjistrimeve te tij ne shtete te tjera jashte Republikes se Shqiperise apo geshtjeve administrative/ligjore te ngritura prej tij ne shtete te ndryshme nga vendi yne, jane jashte objektit gjyqesor dhe nuk kane lidhje me geshtjen ne shqyrtim.

- Qendrimi i Avokatures se Shtetit (ASH) per padine administrative.

Avokatura e Shtetit e la gjykimin ne mungese, me gjitha komunikimin rregullisht te akteve. Gjithashtu,

nuk vuri ne dijeni Gjykatën se cili është qendrimi mbi padinë administrative.

• Vlerësimi i Gjykatës Administrative për padinë.

A.-Juridiksioni gjyqësor, kompetenca, përberja e trupit gjykues dhe kushtet formale të padisë. Juridiksioni gjyqësor administrativ, kompetenca lëndore dhe tokësore. Bazuar në dispozitat e ligjit me Nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative”, nenet 7, germa (a), 8, 9, 10 paragrafi i parë dhe neni 11 paragrafi i parë, neni 4 dhe neni 5 i të Dekretit me Nr. 7818, datë 16.11.2012 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për gdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selise qendrore të gjykatave administrative” të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, referuar objektit, shkakut ligjor dhe palës së paditur të thirrur me anë të padisë në këtë gjykim, kjo gjykatë është kompetente për gjykimin e padisë.

Gjykata nuk ka kompetencë lëndore të shprehët për gështje që në thelb i takojnë të drejtave të paleve ndërgjyqëse të kontestuar mbi regjistrimin e markave respektive, pasi këto çështje hyjnë në kompetencën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Seksioni Tregtar. Gjykata administrative është kompetente për të vlerësuar veprimin administrativ të kryer prej organit publik, Bordi i Apelit pranë DPPI, nëse prej tij cenohen të drejta të ligjshme të pretenduara prej palës paditëse, përsa i përket procedimit administrativ të kryer dhe jo mbi pretendimet e paleve për të drejtat e pronësive industriale, që është një çështje (mosmarreveshje) që mund të shqyrtohet gjyqësisht, për ng kompetencë lëndore vetëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Seksioni Tregtar.

Përberja e trupit gjykues. Padia administrative si është regjistruar në Gjykatë, është caktuar me short të gjykohet si gjyqtar kryesues, prej këtij trupi gjykues. Trupi gjykues për gjykimin e kërkesës, u formua, në zbatim të nenit 12 paragrafi i parë të ligjit, me Nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Ezaurimi i ankimit administrativ përpara depozitimit të padisë në gjykatë. Referuar dispozitës ligjore të ligjit organik me Nr.49/2012, perkatesisht, neni 16, kushti për shterimin e ankimit administrativ, si më poshtë: “Padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ. Përjashtohen nga ky rregull rastet kur:

- a) ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar;
- b) ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtperdrejt në gjykatë;
- c) organi më i lartë në shqyrtimin e një ankimi administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personale të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedimin administrativ.” Gjykata Administrative verën, se ligji me Nr.44/2015 për Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, në pjesën e gjashtë, Kreu i Parë, parashikon si vijon:

Neni 128

Legjitimitimi dhe mjetet e ligjore administrative

1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj gdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.
2. Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, mjetet ligjore administrative mund të ushtrohen për shkak të paligjshmerisë.
3. Mjetet ligjore administrative janë: a) ankimi administrativ, i cili përfshin: i) Ankimin administrativ ndaj aktit administrativ ose mosveprimit të organit publik për nxjerrjen e aktit të brenda afatit të parashikuar dhe/ose veprimit procedural të organit publik gjatë procedurës

administrative (Ankimi administrate ndaj aktit administrativ); ose ii) kundërshtimi administrativ ndaj një veprimi tjetër administrativ nën regjimin e së drejtës administrative (Kundërshtimi administrativ); b) rishikimi.

4. Pala nuk ka të drejtë të ushtrojë për së dyti mjetet ligjore administrative për të njëjten gjë.

Neni 129

Shterimi i mjeteve ligjore administrative

Shterimi i ankimit administrativ, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për gjëshkrimin administrativ, përveç rasteve kur: a) ligji nuk parashikon organ me të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi me të lartë administrativ nuk është konstituuar; b) ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar drejtëpërdrejt në gjykatë; c) organi me të lartë në shqyrtimin e ankimit administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personale të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedurën administrative.

Gjykata vëren se, sipas akteve shkresore të marra në shqyrtim në këtë gjykim, rezulton se në datë 10/07/2017 të jetë kryer veprimi administrativ i palës së paditur për vlerësimin e kundërshtimit të palës paditese, ndaj referuar nenit 185 (dispozita kalimtare) të KPrAd, me interpretim al contrario (në të kundërt të dispozitës ligjore) behen të zbatueshme dispozitat ligjore të përmendura si më lart, për sa kohë Kodi i ri i Procedurave Administrative ka hyr në fuqi në datë 28/05/2016.

Ligji i posagëm, Për pronësinë industriale i ndryshuar, që rregullon marrëdhënjet administrative, objekt i këtij gjykimi, për nga pikepamja materiale parashikon në dispozitën ligjore të nenit 153/4 se, "Vendimi i bordit të apelit për kundërshtimin e paraqitur në bazë të nenit 152 të këtij ligji, mund të apelohej në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bordit.", bazuar në aktet shkresore të depozituara prej palës paditese, konstatohet se është plotësuar kushtin formal të padisë, sipas nenit 16 të ligjit me Nr.49/2012.

Afati i paraqitjes së padisë. Meqenëse, padia është depozituar në gjykatë në datë 31/08/2017 dhe vendimi i palës së paditur (objekt shqyrtimi) është i datës 10/07/2017, por është komunikuar efektivisht palës paditese në datë 03/08/2017, me anë të shërbimit postar konstatohet se, është paraqitur brenda afatit të caktuar me ligj, afati prej 30 ditësh, të sanksionuar në nenin 153/4 të ligjit "Për pronësinë intelektuale", i ndryshuar që parashikon: "Vendimi i bordit të apelit për kundërshtimin e paraqitur në bazë të nenit 152 të këtij ligji, mund të apelohej në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bordit." Gjykata e merr, kryesisht, në vlerësim afatin për paraqitjen e padisë (afatin e parashkrimit), sipas dispozitës të nenit 18, paragrafi i pestë, të ligjit organik, me Nr.49/2012 (lexfori). Për sa më lart, konstatohet se padia përmbush kushtin formal sipas nenit 18 të ligjit me Nr.49/2012. Legjitimitimi Gjykata thekson se, padia administrative, objekt shqyrtimi, sipas nenit 15 germa (a) të ligjit organik, me Nr.49/2012, është e drejta subjektive, e njohur me ligj që ka "gdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik" Në bazë të nenit 17/2 të ligjit organik, me Nr.49/2012 është përcaktuar funksioni gjyqësor, gjatë shqyrtimit të veprimit apo mosveprimit administrativ, duke u sanksionuar se: "Gjykata zgjidh marrëdhënjet në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme. Ajo bën një çështje të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me marrëdhënjet, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët." Objekti i gjykimit, në këtë rast është veprimi administrativ i palës së paditur, me anë të nxjerrjes së aktit administrativ Vendimit Nr. 167/8 Protokolli, datë 10.07.2017 të palës së paditur, duke i'u referuar padisë së depozituar në gjykatë prej palës paditese. Referuar paleve ndërgjyqëse, objektit të kerkimit dhe shkakut ligjor të padisë, në zbatim të nenit 15 germa (a) dhe nenit 17 germa (a) të ligjit organik me Nr.49/2012, gjykata vlerëson se, padia ka legjitimitim aktiv dhe pasiv.

Meqenëse, gjykata arriti në përfundimin si më lart, mbi elementet formalo-thelbesore të padisë, merr në

vleresim bazueshmerine ne ligj dhe ne prova te pretendimeve te ngritura ne padi, si me poshte: Gjykata Administrative si me lart si konstatoi te plotesuara te gjitha kushtet formale ligjore per depozitimin e padise administrative, merr ne shqyrtim pretendimet ne themel te padise.

B. Bazueshmeria ne ligj dhe ne prova i pretendimeve te ngritura ne kerkese-padi.

Ne paragrafin e pare te nenit 37/1 te ligjit organik, me Nr.49/2012 eshte percaktuar se, "Gjykata shqyrton ligjshmerine e veprimit administrativ qe kundershohet, ne baze te provave te paraqitura nga palet dhe te situates ligjore dhe faktike qe ekzistonte ne kohen e kryerjes se veprimit konkret administrativ.", ndersa ne nenin 35 te ligjit organik, me Nr.49/2012 eshte sanksionuar barra e proves si me poshte:

"Organi publik ka detyrimin te provoje ligjshmerine e aktit administrativ, kontrates administrative dhe te veprimit tjeter administrativ, te nxjerre jo me kerkese te paditesit, si dhe faktet qe ai ka parashtruar dhe ka vene ne themel te veprimtarise se kundershohet ne gjykate.

Ne rastet e tjera, pala ka detyrimin te provoje faktet, ne te cilat bazon pretendimin e saj. Por edhe ne keto raste, gjykata, edhe kryesisht, me vendim te ndermjetem, mund te vendose kalimin e barres se proves tek organi publik, kur ka dyshime te arsyeshme, te bazuara ne prova me shkrese, qe vertetojne se organi publik fsheh apo nuk paraqet me dashje fakte dhe prova te rendesishme per zgjidhjen e mosmarreshjes. Ky vendim ankimohet se bashku me vendimin perfundimtar."

Gjykata veren se, objekti i gjykimit, ne kete rast eshte veprimi administrativ i pales se paditur DPPI, qe ka vendosur rrezimin e kundershimit te aplikimit per regjistrim, veprim i kryer mbi bazen e kerkeses se pales paditese, (kundershim per aplikimin e personit te trete per marken "{...}") ne keto kushte i takon barra e te provuarit pales paditese per paligjshmerine e vendimmarrjes se pales se paditur.

Referuar nenit 17/2 te ligjit me Nr.49/2012 eshte percaktuar funksioni gjyqesor ne gjykimin e mosmarreshjeve administrative, si vijon: "Gjykata zgjidh mosmarreshjet ne perputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera ne fuqi, qe jane te detyrueshme. Ajo ben nje cilesim te sakte te fakteve dhe veprimeve qe lidhen me mosmarreshjen, pa u lidhur me percaktimin qe mund te propozojne palet."

Shqyrtimi dhe zgjidhja e nje geshtje nga gjykata nuk mund te bazohet vetem mbi ate qe formalisht shkruhet ne aktet e progesit dhe qe mund te emertohen objekti apo baza ligjore. Gjykatat gjate shqyrtimit te geshtjes qe u shtrohet per gjykim, ka detyrimin te vleresojne dhe te marr parasysh te gjithe permbajtjen e akteve procedurale, te identifikojne shkakun ligjor te kerkimeve ne menyre, qe te mund te jap vendim te drejte per te. Sa me siper eshte shprehur qarte dhe ne Vendimin Unifikues te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte nr.3/2012: "Gjykata e zbulon shkakun e padise se paditesit duke e analizuar padine ne teresine e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore te referuara nga paditesi ne pjesen hyrese te saj. Mund te ndodhe qe paditesi te referoje gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kerkesepadise del e qarte e drejta qe ai kerkon te mbroje. Ne kete rast gjykata duhet te zgjidhe geshtjen konform shkakut qe rezulton nga shqyrtimi ne teresi i kerkesepadise, duke bere lidhjen midis fakteve qe pretendohen prej paditesit se kane ngjare dhe te drejtave apo interesave qe ai pretendon se i jane cenuar".

Duke i'u referuar shkakut ligjor te kerkimeve te paditesit, pavaresisht menyres se formulimit te tyre ne objektin e padise apo ne pretendimet e tij gjate shqyrtimit gjyqesor (akte keto te cilat jane te administruara ne dosjen gjyqesore, pjese perberese te shqyrtimit dhe qe kane qene pjese e debatit gjyqesor), arrin ne konkluzionin se, objekt i ketij gjykimi eshte kundershimi gjyqesor te veprimit administrativ te kryer prej organit administrativ kolegjal te ngritur ad hoc, prane pales se paditur DPPI, ne zbatim te ligjit me Nr.9977/2008 i ndryshuar, per mbrojtjen e pronesise industriale, qe ne baze te ligjit

te posagem me Nr.49/2012 i ndryshuar kategorizohen ne akte administrative dhe veprimeve te tjera administrative.

Ne paragrafin e pare te nenit 37/1 te ligjit organik, me Nr.49/2012 eshte percaktuar se, "Gjykata shqyrton ligjshmerine e veprimit administrativ qe kundershohet, ne baze te provave te paraqitura nga palet dhe te situates ligjore dhe faktike qe ekzistonte ne kohen e kryerjes se veprimit konkret administrativ.", ndersa ne nenin 35 te ligjit organik, me Nr.49/2012 eshte sanksionuar barra e proves. Per rastin objekt gjykimi behen te zbatueshme me prioritet zbatimi hierarkik sipas renditjes pasuese, keto dispozita ligjore:

1. Ligji me Nr.44/2015 Per Kodin e Procedurave Administrative Neni 4

Parimi i ligjshmerise

1. Organet publike ushtrojne veprimtarine e tyre ne perputhje me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshem ne Republikën e Shqiperise, brenda kufijve te kompetencave te tyre dhe ne perputhje me qellimin per te cilin jane dhene keto kompetenca. 2. Te drejtat apo interesat e ligjshem te nje pale nuk mund te cenohen nga veprimi administrativ, perveg se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar nje proces te rregullt ligjor.

Neni 11

Parimi i ushtrimit te ligjshem te diskrecionit

Diskrecioni ushtrohet ligjerisht kur ai eshte ne perputhje me kushtet e meposhtme: a) eshte i parashikuar me ligj; b) nuk tejkalon kufijte e ligjit; c) zgjedhja e organit publik eshte bere vetem per te arritur objektivin per te cilin eshte lejuar diskrecioni dhe eshte ne perputhje me parimet e pergjithshme te ketij Kodi;dhe; g) zgjedhja nuk perben nje shmangie te pajustificuar nga vendimet e meparshme te marra nga i njeiti organ ne raste te njeita apo te ngjashme.

Neni 21

Parimi i kontrollit

Veprimtaria administrative i nenshtrohet: a) kontrollit administrativ, ne perputhje me dispozitat e ketij Kodi mbi mjetet ligjore administrative dhe legjislacionit ne fuqi; b) kontrollit te gjykates, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi; dhe/ose c) gdo kontrolli tjeter, te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 107

Ligjshmeria e aktit administrativ

Akti administrativ eshte i ligjshem nese eshte nxjerre nga organi publik kompetent, ne perputhje me parimet dhe kerkesat ligjore te parashikuara ne kete Kod, si dhe legjislacionin ne fuqi.

Neni 108

Akti administrativ absolutisht i pavlefshem

Akti administrativ eshte absolutisht i pavlefshem ne rastet e meposhtme: a) kur vjen ne kundershitim te hapur dhe flagrant me nje dispozite urdheruese te ketij Kodi dhe legjislacionit ne fuqi lidhur me: i) kompetencen e organit publik; ii) proceduren e nxjerrjes se tij; ose iii) formen ose elemente te tjere te detyrueshem te aktit; b) eshte nxjerre nepermjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit te interesit, falsifikimit apo nje veprimi tjeter qe perben veper penale; c) ekzekutimi i aktit mund te shkaktoje nje veprim te denueshem, sipas legjislacionit penal; g) ne gdo rast tjeter te parashikuar shprehimisht ne ligj. Neni 109

Paligjshmeria e aktit administrativ

Nje akt administrativ eshte i paligjshem nese: a) organi publik qe e ka nxjerre ka vepruar ne mungese te kompetences; b) eshte rezultat i shkeljes te dispozitave lidhur me proceduren administrative; c) eshte

ne kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; g) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi; d) është në kundërshtim me ligjin material; dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

2. Ligji me Nr. 9977/2008, i ndryshuar "Për pronësinë industriale"

Neni 143

Refuzimi për shkaqe relative

1. Marka nuk mund të mbrohet nëse përdorimi i saj bie në kundërshtim me të drejtat e mëparshme.
2. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo duhet të deklarohet e pavlefshme kur:
 - a) është e njëjta me një markë të mëparshme dhe mallrat e shërbimet, për të cilat është aplikuar ose regjistruar ajo, janë identike me mallrat ose shërbimet, për të cilat është mbrojtur marka e mëparshme;
 - b) është e njëjta ose e ngjashme me një markë të mëparshme, e cila mbrohet për mallra apo shërbime identike ose të ngjashme dhe kur, për shkak të njëllojshmërie ose të ngjashmërie, ekziston mundësia e shkakutimit të konfuzionit të publikut, ku përfshihet edhe mundësia e bashkelidhjes me markën e mëparshme;
 - c) është e njëjta ose e ngjashme me një markë të mëparshme, edhe kur është për t'u regjistruar ose është regjistruar për mallra apo shërbime, që nuk janë të ngjashme me ato, për të cilat është regjistruar marka e mëparshme, kur marka e mëparshme ka një reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe përdorimi ose regjistrimi i markës në fjale, pa shkak të arsyeshem, fiton prioritet të padrejtë ose demton natyrën dalluese apo emrin e mirë të markës së mëparshme.
3. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nëse cenon të drejtat e mëparshme, të fituara, si:
 - a) të drejtën e emrit tregtar, me kusht që ky emër ose pjesa thelbësore e tij të jetë e njëjta apo e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet, dhe që pronari i emrit tregtar të prodhojë apo të sigurojë perkatesisht mallra ose shërbime, të njëjta ose të ngjashme me ato të markës, që kërkohet të regjistrohet;
 - b) të drejtën e një personi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e të cilit është e njëjta ose e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet;
 - c) të drejtat e pronësisë industriale, përfshirë emrat e varieteteve të mbrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe të treguesve gjeografike;
 - g) të drejtat e autorit të një veprë ose të një pjese të saj, me kusht që ajo të jetë e njëjta ose e ngjashme me markën, që kërkohet të mbrohet.
4. Marka nuk mbrohet, nëse është e njëjta ose e ngjashme me një markë të regjistruar, për mallra apo shërbime të njëjta ose të ngjashme dhe nëse vlefshmeria e saj ka mbaruar për shkak të mbarimit të afatit të mbrojtjes, për një periudhë gjashtëmujore nga mbarimi i këtij afati.
5. Marke të mëparshme, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, vlerësohet:
 - a) marka, me një datë aplikimi për regjistrim më të hershme sesa data e aplikimit për regjistrim të një marke tjetër tregtare, duke pasur parasysh, kur është rasti, pretendimin për prioritet për atë markë, sipas nenit 147 të këtij ligji;
 - b) marka, që është regjistruar më parë, nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është pale;
 - c) aplikimi për një markë, sipas përcaktimit të shkronjave "a" e "b" të kësaj pike, në varesi të regjistrimit të tyre;
 - g) marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së

Parisit, te publiku i sektorit perkates, si rezultat i perdorimit, perfaqesimit, publikimit ose reklamimit, ne perputhje me parashikimet e DPPM-se dhe te autoriteteve nderkombetare.

Neni 144

E drejta per marke

E drejta ekskluzive per markat, sipas ketij ligji, fitohet nepermjet regjistrimit te tyre ne DPPM.

Neni 147

E drejta per prioritet

1. Aplikimi per regjistrimin e nje marke, i depozituar prane DPPM-se, mund te permbaje nje deklarate, ku kerkohet prioritet dhe te gezoje nje te drejte prioriteti, kur ai eshte i njejte me nje aplikim te meparshem e te rregullt kombetar, te depozituar per te njejten marke dhe per te njejtat mallra dhe/ose sherbime nga aplikanti ose zevendesuesi i tij ligjor, ne baze te:

legjislacionit kombetar te njerit prej shteteve anetare te Konventes se Parisit; legjislacionit kombetar te njerit prej shteteve anetare te Organizates Boterore te Tregtise.

Aplikim i rregullt kombetar, quhet gdo aplikim, i cili ka plotesuar kerkesat e nevojshme, per te marre nje date depozitimi, pavaresisht se gfare ka ndodhur me vone me te.

2. Aplikimi i depozituar sipas pikes 1 te ketij neni, gezon te drejten e prioritetit nga data e depozitimit te aplikimit te pare, me kusht qe kerkesa prane DPPM-se te behet brenda nje periudhe gjashtemujore nga data e depozitimit te aplikimit te pare. E drejta e prioritetit, e fituar si me siper, sjell si pasoje qe data e prioritetit quhet si date depozitimi e aplikimit per regjistrimin e markes prane DPPM-se, me qellim per te percaktuar se cili aplikim gezon nje te drejte te meparshme.

3. Aplikanti, i cili synon te perdore te drejten e prioritetit, ne perputhje me piken 2 te ketij neni, paraqet ne DPPM te gjithe informacionin per aplikimin e pare (daten, vendin dhe numrin e aplikimit te pare) dhe, brenda nje periudhe tremujore nga data e paraqitjes se kerkeses, depoziton ne DPPM nje kopje te aplikimit te pare dhe perkthimin e tij ne shqip.

Neni 152

Kundershtimi ndaj nje marke

1. Kundershtimi ndaj nje marke te publikuar depozitohet ne DPPM brenda nje periudhe tremujore nga data e publikimit, kundrejt pageses se tarifes perkatese, nga:

a) aplikanti i nje marke te meparshme te depozituar ne DPPM, ose nga pronari i nje marke te meparshme, regjistruar ne perputhje me parashikimet e pikave 1 e 2 te nenit 143 te ketij ligji;

b) pronari i nje emri tregtar, ne perputhje me percaktimin e shkronjes "a" te pikes 3 te nenit 143 te ketij ligji;

c) nje person fizik, ne baze te percaktimit te shkronjes "b" te pikes 3 te nenit 143 te ketij ligji;

g) pronari i nje te drejte te meparshme te pronesise industriale, ne baze te percaktimit te shkronjes "c" te pikes 3 te nenit 143 te ketij ligji;

d) gdo person, qe ka te drejten e autorit, sipas percaktimit te shkronjes "g" te pikes 3 te nenit 143 te ketij ligji.

2. Periudha per paraqitjen e kundershtimit nuk mund te zgjatet pertej periudhes se parashikuar ne piken 1 te ketij neni.

3. DPPM-ja njofton me shkrim aplikantin e markes, kunder se ciles eshte depozituar kundershtimi.

4. Te dhenat per menyren e depozitimit te kundershtimit dhe procedura e nevojshme parashikohen ne rregulloren perkatese.

Neni 153

Shqyrtimi i kundershtimit

1. Bordi i apelimit i DPPM-se shqyrton nese kundershtimi i depozituar eshte ne perputhje me kerkesat e

pikes 1 te nenit 152 te ketij ligji. Qdo pale ka te drejte te marre pjese ne proceduren e kundershimit, si dhe te paraqese argumentet e veta, me goje ose me shkrim, brenda nje periudhe kohore, te caktuar nga bordi i apelimit.

2. Gjate shqyrtimit, bordi i apelimit ka te drejte t'u kerkoje paleve te paraqesin materiale dhe dokumente te tjera shtese, brenda nje periudhe, te parashikuar, per kete qellim, ne rregulloren, dale ne zbatim te ketij vendimi.

3. Bordi i apelimit shqyrton kundershimin brenda nje periudhe tremujore nga data e paraqitjes se tij dhe njofton palet per vendimin e marre.

4. Vendimi i bordit te apelimit per kundershimin e paraqitur ne baze te nenit 152 te ketij ligji, mund te apelohe ne gjykate brenda 30 diteve nga data e marrjes se njoftimit te vendimit te bordit.

Neni 154

Regjistrimi i markes

1. DPPM-ja, pas miratimit te dates se depozitimit, ekzaminon aplikimin brenda nje periudhe tremujore, nese ai eshte ne perputhje me kerkesat e pikave 2 e 3 te nenit 140, si dhe me kerkesat e nenit 142 te ketij ligji.

2. Gjate ekzaminimit, DPPM-ja ka te drejte t'i kerkoje aplikantit materiale dhe dokumente shtese.

Periudha, brenda se ciles aplikanti duhet t'ia paraqese ato DPPM-se, parashikohet ne rregulloren e kesaj drejtorie.

3. DPPM-ja, ne perputhje me rezultatet e ekzaminimit, vendos per regjistrimin ose per refuzimin e markes. Pas perfundimit te periudhes tremujore te publikimit te markes, aplikanti njoftohet per vendimin e marre. Kur vendimi eshte ne favor te regjistrimit, aplikantit i kerkohet te paguaje tarifen e regjistrimit te markes.

4. DPPM-ja e refuzon aplikimin per regjistrimin e markes, kur aplikimi nuk permbush kushtet e parashikuara ne nenet 140 pikat 2 e 3 dhe 142 te ketij ligji.

5. Kur aplikanti paguan tarifen e regjistrimit brenda periudhes se parashikuar ne rregullore, DPPM-ja regjistron marken ne regjistrin e markave dhe leshon certifikaten e regjistrimit, brenda nje periudhe tremujore nga data e pageses se tarifes.

6. Kur aplikanti nuk e paguan tarifen e regjistrimit, brenda periudhes se parashikuar ne rregullore, DPPM-ja refuzon aplikimin per regjistrimin e markes.

7. DPPM-ja ben publikimin e markes se regjistruar ne buletin.

8. Te dhenat, qe jepen ne certifikaten e regjistrimit te markes dhe ato qe publikohen per marken e regjistruar, parashikohen ne rregulloren perkatese.

Neni 155

Apelimi i vendimit

1. Brenda nje periudhe dymujore nga data e marrjes se njoftimit per refuzimin e aplikimit, sipas neneve 15 pika 5 dhe 154 pika 4 te ketij ligji, aplikanti ka te drejte, kundrejt pageses se tarifes perkatese, te apeloje vendimin e DPPM-se ne bordin e apelimit.

2. Bordi i apelimit shqyrton kerkesen per apelim brenda nje periudhe tremujore nga data e paraqitjes se tij dhe njofton apeluesin per vendimin e marre.

3. Gjate shqyrtimit, bordi i apelimit ka te drejte t'i kerkoje apeluesit te vendimit te paraqese materiale dhe dokumente te tjera shtese, brenda nje periudhe te parashikuar per kete qellim ne rregulloren perkatese.

4. Vendimi i bordit te apelimit per refuzimin, ne perputhje me piken 5 te nenit 150 te ketij ligji, eshte i formes se prere.

5. Vendimi i bordit te apelimit per refuzimin, ne perputhje me piken 4 te nenit 154 te ketij ligji, mund te kundershtohet ne gjykate brenda 30 diteve nga data e marrjes se njoftimit te ketij vendimi.

Neni 160

Kufizimi i pasojes se pranimit ne heshtje

1. Kur pronari i nje marke te meparshme, ne perputhje me percaktimin e pikes 5 te nenit 143 te ketij ligji, pranon ne heshtje, per nje periudhe te panderprere pesevjegare, perdorimin e nje marke te regjistruar me vone ne Republiken e Shqiperise, ai nuk ka me te drejte, sipas se drejtes qe rrjedh nga regjistrimi i markes se meparshme, te kerkoje deklarimin e pavlefshem te markes se mevonshme ose ta kundersiztoje perdorimin e markes se mevonshme per mallrat ose sherbimet, per te cilat marka e mevonshme eshte perdorur, perveg kur regjistrimi i markes se mevonshme eshte aplikuar ne keqbesim.
2. Pronari i markes se mevonshme nuk ka te drejte te kundersiztoje perdorimin e markes se meparshme.

Neni 162

Transferimi i pronesise se markes

1. DPPM-ja, me kerkesen e pronarit te markes ose te pronarit te ri te saj, regjistron transferimin e pronesise se nje marke ne regjistrin e markave, kundrejt pageses se tarifes perkatese.
2. Pronari i nje marke te regjistruar mund te transferoje te drejtat mbi marken, te gjitha ose nje pjese te tyre, nepermjet nje marreveshjeje te nenshkruar nga te dyja palet, e cila depozitohet ne DPPM.
3. Te drejtat mbi marken mund te transferohen se bashku me veprimtarine e biznesit ose pa e transferuar kete te fundit.
4. Transferimi nuk ka asnje efekt ligjor, nese nuk eshte i regjistruar ne regjistrin e markave. Kur nga akti i transferimit duket qarte se transferimi i pronesise mbi marken mund te keqinformoje publikun per natyren, cilesite dhe origjinen gjeografike te mallrave dhe/ose sherbimeve, per te cilat eshte regjistruar marka, DPPM-ja refuzon te regjistroje transferimin, nese pronari i ri i markes nuk pranon ta kufizojte regjistrimin vetem per mallrat dhe/ose sherbimet, te cilat nuk gojne ne keqinformimin e publikut.
5. DPPM-ja refuzon regjistrimin ne regjister te nje transferimi pronesie te kerkuar, ne rast se dokumentacioni perkates nuk paraqitet brenda afatit te caktuar.
6. Te dhenat per depozitimin e kerkeses dhe procedura per regjistrimin e ndryshimit te pronesise parashikohen ne rregulloren perkatese, dale ne zbatim te ketij ligji.

Gjykata si me lart thekson per palet ndergjyqese s, pavaresisht pretendimeve te paleve ne lidhje me te drejten e pronesise industriale qe lidhen me marken "{...}", kjo gjykate nuk ka kompetence lendore per te shqyrtuar keto pretendime por objekti i ketij gjykimi eshte vetem vendimmarrja administrative e pales se paditur DPPI. Gjykata e merr ne shqyrtim kete vendimmarrje ne perputhje me parashikimin e nenit 37/1 te ligjit organik duke shqyrtuar ligjshmerine e veprimit administrativ qe kundersiztohet, ne baze te provave te paraqitura nga palet dhe te situates ligjore dhe faktike qe ekzistonte ne kohen e kryerjes se veprimit konkret administrativ.

Pala paditese ka paraqitur para Bordit te Apelimit, ne date 30/12/2016, pretendimin se marka per te cilin ishte paraqitur aplikimi per regjistrim nga personi i terte cenon te drejten e markave te regjistruara me pare prej tij. Paditesi ka pretenduar se aplikimi per marke eshte identik me markat e {...} shpk, per mallra te njejte ose te ngjashem si dhe ekziston mundesia reale e shkaktimit te konfuzionit te publikut. Gjykata veren se pala paditese ka depozituar kundersizhtimin ne date 30/12/2016 dhe pala e paditur ka marr vendim ne date 10/07/2017, jashte afatit ligjor 3 mujor, qe ka sanksionuar dispozita ligjore, pika 3 nenit 153, duke mos paraqitur ne Gjykate Administrative, organi administrativ, se per cilen arsye apo shkak ka vepruar tej afati te caktuar me ligj . Gjykata Administrative gmon se vendimmarrja e gdo organi administrativ pertej afatit te caktuar me ligj, per ushtrimin e kompetences ligjore (qe ne kete rast eshte shqyrtimi i kundersizhtimit te regjistrimit te markes prej personit te terte) e ben pavlefshme ate.

Neni 91 i ligjit me Nr.44/2015 Kodi i Procedura Administrative ka sanksionuar se. "Procedura

administrative, e nisur me kerkese, me perjashtim te rastit kur parashikohet ndryshe ne kete Kod, perfundon sa me shpejt te jete e mundur dhe brenda afatit te percaktuar nga ligji i posagem””5. Mosrespektimi i afateve kohore, te parashikuara ne kete nen, duhet te justifikohet nga organi pergjegjes para organit epror ose nga nepunesi pergjegjes perpara eprorit te tij, brenda 10 diteve nga perfundimi i afatit ose nga perfundimi i gjendjes se jashtezakonshme.” Ndersa nei 92 ka njohur te drejten e organit administrativ qe procedon per zgjatjen e afatit te procedures, si vijon : “1. Perverg kur ndalohet shprehimisht nga ligji, ne raste te justifikuara, per shkak te kompleksitetit te geshtjes, organi publik mund te zgjase vetem nje here afatin e percaktuar sipas nenit 91 te ketij Kodi. 2. Zgjatja e afatit behet per aq sa eshte e nevojshme per perfundimin e procedures, ne proporcion me veshtiresine e geshtjes konkrete, por jo me shume se kohezgjatja e afatit fillestar. 3. Zgjatja e afatit dhe data e perfundimit te afatit te zgjatur i njoftohen pales brenda afatit fillestar. Njoftimi duhet te permbaje edhe arsyetimin per zgjatjen e afatit.” Pala e paditur, organi administrativ nuk ka paraqitur prova ne Gjykate qe te kete zgjatur afatin per proceduren e shqyrtimit te kundershimit.

Gjithashtu, Gjykata Administrative cmon se pala paditese provoi se, te jete mbajtese e Markes tregtare {...} +emblema, qe e ka te transferuar, sipas nenit 162 te ligjit prej pronarit te meparshem, rrjedhimisht ne baze te ligjit gezon cdo mbrojtje ligjore, sidomos prej autoritetit shteteror pergjegjes. Sipas provave shkresore te depozitura prej pales paditese rezultoi se, sipas Deshmise se Depozitimit me Nr.12/93, ne date 11/06/1993, ora 12.40 ne Dhomen e Tregtise te RPSSH eshte depozituar kerkesa per regjistrimin e markes tregtare {...} +emblema, ne emer te Kombinantit te te Prodhimit te Pijeve Alkolike “Ali Kelmendi” Tirane, per mallrat e perfshira ne klasen 33. Bashkelidhur deshimise ne dy faqe eshte pershkrimi narrativ i markes, me elementet dallues dhe pamja vizive e markes. Ne date 06/07/2000, me Nr.122/3 Regjistrimi eshte njoftuar autoritet shteteror ne RSH per ndryshimin e pronesis se Markes, te regjistruar si me lart, per tek Shoqeria tregtare “{...}” shpk, qe eshte pala paditese.

Personi i trete i thirrur kryesisht prej Gjykates, “Kantina e Pijeve {...}”, sha, qe eshte edhe aplikant per regjistrim e markes, eshte mbajtes i se drejtes se emrit tregtar prej vitit 1995. Gjithashtu, personi i trete ka regjistruar ne Shqiperi prej vitit 2003 e ne vijim tri marka me emertim: “Gjergj Kastrioti {...}” ku elementi figurativ, simboli mesjetar i Kastrioteve, si dhe ai verbal i stilizuar {...}, jane elemente dominante. Personi i trete ka ngritur qendrimin ne gjykim se, Marka "GJERGJ KASTRIOTI {...}" ose shkurtimisht e njohur edhe si "{...}" e Kantines Gjergj Kastrioti {...}, ka fituar nje karakter dallues teper te larte gjate perdorimit te saj ne lidhje me produktet alkoolike. Produktet alkoolike me emrin dhe logon "{...}" jane shitur e tregtuar ne menyre te panderprere nga personi i trete prej shume dekadash duke filluar nga vitet 70'(d.m.th. shume kohe perpara dates se themelimit te shoqerise "{...}"shpk) deri ne ditet e sotme.Pra, pronari me i hershem qe ka tregtuar marken tregtare me emrin dhe logon "GJERGJ KASTRIOTI {...}" per pije alkoolike, per me shume se 5 dekadash, eshte Kantina Gjergj Kastrioti {...}, cka provohet edhe me faturat e shitjeve qe i jane paraqitur rregullisht Bordit te Apelimit te DPPI-se. Gjykata veren se personi i trete nuk ka depozituar prova shkresore qe te provojne mbrojtjen e markave qe ka regjistruar, perpara vitit 2003, sic edhe prapeson, qe prej viteve '70, pasi faturat e shitjes se nje malli nuk provojne se gezon mbrojtje ligjore nje marke.

Organi administrativ, DPPI ne rrezimin e kundershimit per regjistrimin e markes, sipas vendimit me Nr. 167/8 Prot., date 10.07.2017, ka argumentuar si vijon: “Ne vijim, Bordit i Apelimit mori ne shqyrtim pretendimet e aplikantit, i cili pretendon ne argumentet dhe pro vat e paraqitura, se ne kuptim te ligjit “Per Pronesine industriale” (i ndryshuar), eshte ai vete mbajtesi i se drejtes se meparshme mbi shenjen ne konflikt. Sa me siper, Bordi i Apelimit konstaton se aplikanti eshte mbajtes i se drejtes se emrit

tregtar prej vitit 1995. Gjithashtu aplikanti ka regjistruar ne Shqiperi prej vitit 2003 e ne vijim tri marka me emertim: “Gjergj Kastrioti {...}” ku elementi figurativ, simboli mesjetar i Kastrioteve, si dhe ai verbal i stilizuar {...}, jane elemente dominante.”

Markat e kundershtruara si vijon:

4- Me numer regjistrimi kombetar 9722, e mbrojtur prej 02.12.2003 per brandy (pije alkoolike) te klases 33, ne fuqi deri ne 02.12.2023, me pamje:

5- Me numer regjistrimi kombetar 10060, e mbrojtur prej 03.01.2004 per brandy (pije alkoolike) te klases 33, ne fuqi deri ne 3.01.2024, me pamje:

6- Me numer regjistrimi kombetar 16857, e mbrojtur prej 18.02.2016, per brandy (pije alkoolike) te klases 33, ne fuqi deri ne 18.02.2026, me pamje:

Ne driten e ketyre fakteve, si dhe te provave te depozituara nga palet ne kete shqyrtim administrativ, rezulton se te dyja shoqerite jane mbajtese ligjore mbi shenjen ne konflikt, duke e perdorur ate secila ne menyre te pavarur, qetesisht dhe panderprerje, per me shume se 10 vjet. Themi qetesisht dhe panderprerje per shkak se cdonjera prej paleve ka deshmuar vijueshmerine e perdorimit te shenjes nder vite. Po ashtu, nuk eshte depozituar asnje dokument apo prove qe te vertetoje qe gjate periudhes nga aplikimi i markave te sipercituara, te regjistruara nga shoqeria Kantina e Pijeve “Gjergj Kastrioti {...}” Sha, e deri me sot, kundershtruesi te kete ushtruar te drejtat e tij te njohura nga nenet 152, 173, 174 dhe 184 e vijues te ligjit 9947, date 07.07.2008 (i ndryshuar). Sa me siper, Bordi i Apelimit konstaton se jemi ne kushtet e percaktuara nga neni 160 i ligjit 9947, date 07.07.2008 (/ ndryshuar)” Vijon argumenti i vendimmarrjes administrative te pales se paditur , se “Vlen te theksohet edhe nje here ne mbeshtetje te kesaj dispozite, se ne dosjen e kundershtrimit nuk gjendet as ndonje dokument qe provon qe gjate ketyre rreth 13 viteve, d.m.th. prej vitit 2003, kundershtruesi te kete depozituar padi ne Gjykate per te kerkuar, shfuqizimin e markave te mevonshme me pretendimin se shoqeria Kantina e pijeve “Gjergj Kastrioti {...}” ka regjistruar markat ne keqbesim. Ne perfundim, Bordi i Apelimit vlereson se, ne kushtet kur jane ezauruar te gjitha mekanizmat ligjore ne favor te mbrojtjes se te drejtes ekskluzive mbi shenjen ne konflikt, nuk mund te pretendohet nga kundershtruesi ne kete moment per te drejta te meparshme mbi marken e pretenduar, ne kuptim te nenit 160 te ligjit 9947, date 07.07.2008 (i ndryshuar)

Gjykata veren se, organi administrativ, DPPI qe ka cilesine e pales se paditur ne kete gjykim, nuk ka depozituar asnje prove, te cilat ka patur ne vleresim per vendimmarrjen, qe eshte objekt i gjykimit. Objekti i shqyrtimit te pales se paditur duhet te ishte «kundershtimi i regjistrimit si marke tregtare i aplikacionit {...}, Nr. AL/T/2016/167 date 03.08.2016» dhe jo sic argumenton ne pjesen arsyetuese te vendimmarrjes, qe i referohet markave te regjistruara ne vitin 2003 e ne vijin prej personit te trete, pasi pala ankuese, qe eshte edhe pala paditese ne kete gjykim, nuk ka pretenduar «deklarimi i pavlefshem i markave tregtare te regjistruara nga aplikanti ne datat 02.12.2003 ; 03.01.2004 dhe 18.02.2016 ». Gjykata gmon se rrjedhimisht edhe referim prej pales se paditur ne zbatimin e nenit 160 te ligjit me nr.9977/2008 i ndryshuar eshte i gabuar, nen objektin e kerkeses qe duhet te shqyrtonte ky organ administrativ.

Neni 160 i ligjit material me Nr.9977/2008 i ndryshuar parashikon se, “1. Kur pronari i nje marke te meparshme, ne perputhje me percaktimin e pikes 5 te nenit 143 te ketij ligji, pranon ne heshtje, per nje periudhe te panderprere pesevjegare, perdorimin e nje marke te regjistruar me vone ne Republiken e Shqiperise, ai nuk ka me te drejte, sipas se drejtes qe rrjedh nga regjistrimi i markes se meparshme, te kerkoje deklarimin e pavlefshem te markes se mevonshme ose ta kundershtojte perdorimin e markes se mevonshme per mallrat ose sherbimet, per te cilat marka e mevonshme eshte perdorur, perveg kur regjistrimi i markes se mevonshme eshte aplikuar ne keqbesim.2. Pronari i markes se mevonshme nuk

ka te drejte te kundershitoje perdorimin e markes se meparshme.” dhe do te duhej te zbatohet prej pales se paditur nese prej pales paditese kundershton markat tregtare te regjistruara nga personi i trete, ne datat 02.12.2003 ; 03.01.2004 dhe 18.02.2016.

Ne kete gjykim edhe personi i trete ka shprehur qendrim se, “...marka e kundershtuar {...} me numer kombetar aplikimi AL/T/2016/167 eshte kerkuar te regjistrohet edhe per mallrat "shishe pijesh" qe i perkasin klases 21 te Klasifikimit te Nices (jo vetem per mallrat produkte alokolike qe perfshihen ne klases 33), kjo marke nuk eshte e ngjashme nga pikepamja konceptuale me markat e paditesit. Sic u tha edhe me siper, personi i trete duke i shtuar elementin literal "Durres" e ben edhe me te dallueshme kete marke te re nga markat e paditesit.” por edhe nga Gjykata konstatohet se. ndodhemi perpara rastit te aplikimit per regjistrim te markes se re dhe organi administrativ, pale e paditur duhej te zbatonte nenit 140 e vijues te ligjit me Nr.9977/2008 per vleresimin e kundershimit te pales paditese. Duhet qe pala paditur te merrte prova, gjate procedimit administrativ, per te arritur ne perfundim nese cenon te drejta te mbrojtura te pales paditese, sipas regjistrimit te markes tregtare, sipas Deshmise se Depozitimit me Nr.12/93, ne date 11/06/1993, ora 12.40 ne Dhomen e Tregtise te RPSSH eshte depozituar kerkesa per regjistrimin e markes tregtare {...} +emblema, ne emer te Kombinantit te te Prodhimit te Pijeve Alkolike “Ali Kelmendi” Tirane, per mallrat e perfshira ne klases 33. Bashkelidhur deshimise ne dy faqe eshte pershkrimi narrativ i markes, me elementet dallues dhe pamja vizive e markes, qe rezulton e provuar qe date 06/07/2000 te jete transferuar prane pales paditese, transferim i regjistruar prane DPPI-se.

Gjykata cmon se, pala paditese ne kete gjykim arriti te provoj paligjshmerine e vendimmarrjes se pales se paditur, pasi u provua te kete disponuar me vendim (a) pertej afatit te caktuar ne ligjin e posacem 9977/2008 i ndryshuar, sipas nenit 153/3 dhe u (b) provua se eshte vleresuar dhe shqyrtuar administrativisht jo objekti i kundershimit sipas kerkeses se pales paditese. Gjykata veren se, organi administrativ, DPPI qe ka cilesine e pales se paditur ne kete gjykim, nuk ka depozituar asnje prove, te cilat ka patur ne vleresim per vendimmarrjen, qe eshte objekt i gjykimit.

Perfundimisht, gjykata vlereson te pranoj teresisht kerkesepadine e pales paditese kundrejt pales se paditur, si te bazuar ne ligj dhe ne prova.

Meqenese Gjykata Administrative arriti ne perfundimin si me lart per pranini e paditese, referuar nenit 40 te ligjit me Nr.49/2012 i ndryshuar ligjeron marrjen e mases se sigurimit te paditese, sipas vendimit te ndermjetem date 13/09/2017 te saj.

Per sa i perket kerkeses se pales paditese per gjobitjen e perfaqesuesit ligjor te personit te trete, ne zbatim te nenit 34 te Kodit te Procedures Civile gmohej prej Gjykates te mospranohet kerkesa. Ndersa per sa i perket veprimeve te Av.Z.Krenar Lologi, si perfaqesues ne kete gjykim, per shkak te pretendimit te pales paditese dhe marredhenieve midis tyre, te meparshme perpara regjistrimit te paditese, Gjykata nuk ka kompetence lendore shqyrtimi, pasi i jane caktuar si kompetence Komisionit Disiplinor te Dhomes Kombetare te Avokatese, sipas rregullimit ligjor per rregullimin e profesionit te avokatit ne RSH.

-Shpenzimet gjyqesore.

Shpenzimet gjyqesore te provuara, qe te jene kryer prej pales paditese jane:

1. Taksa gjyqesore per padine 3.000 leke
2. Shpenzime per realizimin e njoftimeve 200 leke
3. Pagesa e avokatit te pales paditese 1200 Euro

Totali i shpenzimeve gjyqesore jane prej 1200 Euro dhe 3200 (tre mije e dyqind) leke, i ngarkohen pales se paditur ne totalin e tyre, meqenese padia u pranua teresisht.

Ndersa shpenzimet gjyqesore te personit te trete, per avokatin prej 247.560 Lek, meqenese u bashkua ne gjykim me qendrimin e pales se paditur i mbeten sic jane kryer.

Per keto arsye

Baza Ligjore:

Gjykata, ne mbeshtetje te neneve, 14, 40, 44 e 45 e vijues te ligjit organik Nr.49/2012 “Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative”, te neneve 102-110, te neneve 306, te Kodit te Progedures Civile, i ndryshuar dhe ligjit me Nr.9977/2008 “Per pronesine industriale” i ndryshuar

VENDOSI:

Vendosi:

1. Pranimin e padise administrative me Nr. 4569, date 31/08/2017 Regjistrimi.
2. Shfuqizimin teresisht te aktit administrativ, Vendimi me Nr. 167/8 date 10/07/2017 te Bordit te Apelimit prane pales se paditur, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale.
3. Ligjerimin e mases se sigurimit te padise, marr me vendimin e ndermjetem date 13/09/2017 te Gjykates Administrative Shkalla e Pare, Tirane.
4. Mospranimin e kerkeses se pales paditese, shoqeria tregtare “{...}” shpk per gjobitjen ne masen prej 100.000 Lek ndaj perfaqesuesit ligjor te personit te trete ne gjykim, ne zbatim te nenit 34 te Kodit te Procedures Civile.
5. Shpenzimet gjyqesore te provuara si te parapaguara nga pala paditese jane ne ngarkim te pales se paditur, ne totalin e tyre.

Ndaj ketij vendimi lejohet e drejta e ankimit ne Gjykatën e Apelit Administrativ, sipas afatave ligjore!

U shpall sot me date 27/10/2017, ne Tirane!

SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkesepadia	0
Taksa Gjyqesore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

{...}